

## Pasthënie

Edhe nëse e ke lexuar të gjithë librin apo vetëm disa nga faqet e tij, para se të arrini te pasthënia, ju do të keni kuptuar se, në qoftë se emrat, datat dhe ngjarjet historike në këtë libër do të ishin të zëvendësuara me ato të ditëve të sotme, do të ndryshonte shumë pak gjë ose aspak. Nga përshkrimi i Hillit për propagandën e medias, kushtet që fëmijët i pranojnë në shkollë, mësimet e bazuara në frikë të predikuara nga religjionet, dieta e varfër e njerëzve dhe shprehitë e shëndetit, deri në klimën sfiduese ekonomike, shumë pak duket se kanë ndryshuar në vetëdijen dhe në përvojën tonë kolektive.

Lajmet e mira janë se asnjëherë nuk është vonë për një fillim të ri, për rilindjen në vetëdije. Ashtu siç Hilli na përkujton neve: “Unë gjithashtu kam zbuluar se pas çdo përvoje dështimi të sërëkohshëm, pas çdo humbjeje dhe pas çdo forme fatkeqësie gjatë një farërat e një përfitimi ekuivalent”. Rrugat jonë, me sa duket, është e kompozuar nga polariteti i dështimit dhe suksesit. Një mënyrë më e thjeshtë për ta kuptuar këtë bisedë me djallin është se parimet e Hillit na mësojnë neve se “si të dështojmë suksesshëm” në jetën tonë. Ky është një paradoks i natyrës shpirtërore, që ai i përshkruan njerëzit si të rritur me “ritmin hipnotik”, duke zbuluar kështu “veten tjetër” të tyre, gjë që gjithashtu mund të identifikohet si vetja e vetes, vetja më e lartë ose vetja autentike.

Është inkurajuese të mendosh se si shumë nga autorët shpirtërorë, filozofikë dhe madje edhe ata shkencorë ndajnë pikëpamjen e tyre me atë të Hillit për atë që ata e quajnë “qëllim i përcaktuar” ose, siç quhet në kohërat e sotme, “synimet e përcaktuara”, kur qëllimi ynë është që të zgjohemi nga “ritmi hipnotik” i jetesës, atë që hindutë e quajnë mashtrim dhe budistët e quajnë iluzion individual ose ndërjegje kolektive. Ne së bashku me familjen tonë globale përfitojmë.

Integriteti i Hillit shkëlqen përmes përshkrimeve të tij, kur shpjegon se çfarë do të thotë të manifestosh sukses. Në fakt, ai pa hezitim proklamon se “çdo person ka në dorë të marrë “përfitime” nga “vetja tjetër” e tij, derisa nuk ka “rënë në lakmi”. Kjo deklaratë dinjitoze shpirtërore përshkallëzon suksesin në një çështje të vetëdijes. Sukses nuk do të thotë domosdoshmëri që, “ai që ka shumicën e lodrave fiton.” Hilli kështu eliminon konfuzionin e ngritjes shpirtërore sa i përket kapacitetit për të manifestuar gjërat në jetë, sepse asnjëherë nuk mund të thuhet se mjafton, gjithnjë ka më “shumë”.

Ne, gjithashtu, mësojmë për rëndësinë e vetëdijesimit, pasjen e një mendjeje të shëndoshë me anë të djallit të Hillit, i cili kënaqet nga njerëzit që nuk duan të mendojnë për përparimin e tyre. Mendja njerëzore dhe kapaciteti i saj duhen parë më admirim dhe respekt dhe duhet t’i jemi mirënjohës Zotit për këtë dhuratë që na ka bërë. Mendja jo vetëm që formon peizazhin tonë, por krijon edhe rrethanat e jashtme. Tani le të mos luftojmë me mendje, por le të vlerësojmë nuancat e saj, intuitën e saj, kapacitetet e saj maksimale, në kuptimin se mendja është çelësi që na drejton, na fuqizon dhe na vesh me vetëbesim.

Parimi tjetër pas “endjes”, trajta më e rrezikshme që Hilli na përshkruan, është “mungesa e kujdesit” ose atë që ne mund ta quajmë mungesa e mprehtësisë (dallimit). Mprehtësia është relative me urtinë, gjë që na shkakton neve të mendojmë për jehonën para se të marrim një aksion, si dhe me ndershmëri t’i observojmë rezultatet e zgjedhjeve tona. Kështu ne mund të krijojmë rrugën tonë deri te liria.

Në mendjen e lexuesve të tij modernë, mësimet e Hillit janë më shumë të lidhura me prosperitetin, gjë që përkthehet si para në xhepat e individit. Por e vërteta duhet të thuhet: ai ka ndarë me botën urtinë e tij “si të jetosh me parimet”, duke filluar me qenien e brendshme të personit, gjendjen e brendshme të

vetëdijes së personit, duke na ftuar që të shfaqim paraqitjen e jashtme të potencialit tonë më të lartë dhe jo vetëm për përfitimin tonë, por për të gjithë njerëzimin.

Unë dua të shtoj se kjo ishte një urtësi e udhërrëfyer nga ana e fondacionit të Napoleon Hillit, që ta lërë trashëgimi këtë dorëshkrim të çmuar, falë duarve "të afta" të Sharon Lechter-it. Studimet e shumta të saj për vite të tëra mbi parimet e vërteta të Hillit dhe, mbi të gjitha, praktikimi i këtyre parimeve cipeve nga ana e saj, e kanë bërë atë një kandidate perfekte që tani t'ia ofrojë këtë dorëshkrim botës.

Të gjithë lexuesit e Hillit le të lirohen nga sistemet e kushtëzuara të besimit dhe ta jetojnë jetën me pasuritë dhe me të gjitha bukuritë e saj të shkëlqyeshme, duke e shpërndarë dhuratën e tyre, talentet, shkathtësitë në këtë planet, që të gjithë ne e quajmë shtëpi. Paqja dhe pasuria ju bekoftin në jetën tuaj!

- Michael Bernard Beckwith

---

Michael Bernard Beckwith është autor i librit "*Spiritual liberation: fulfilling your soul's potencial*", si dhe i dokumentarit "*The secret*".

Ai është themelues i "*Agape international spiritual center*" dhe bashkëthemelues i "*Association for global*" dhe "*Season for non violence*".

## Reflektime

Përmes shkrimeve të tij, Napoleon Hilli na shfaq një spirualitet të fuqishëm, që shprehet në formësimin e metodave dhe moralit të tij. Në shumë pjesë të librit "*Mposhtja e djallit*", ky fondacion religjioz për sistemin e tij të besimit ndoshta është më i singerti.

Disa nga deklaratat e tij për të keqen dhe frikën, për "mospërcaktimin" dhe "endjen", e kanë prejardhjen nga tradita amerikane religjioze, që daton shumë herët, së paku në transcendentalizmin e Ralph Waldo Emerson-it, në mesin e shekullit XIX. Aktualiteti në spirualitetin amerikan në ditët e Hillit (gjatë shkrimit të këtij libri në vitin 1930) përfshin Norman Vincent Peale, Emmett Fox dhe në fiksionin inspiruese të popullarizuar të Lloyd C. Douglas. Evangjelizmi shumë personal e kristian nga Aimee Semple McPherson dhe Billy Sunday ishin gjithashtu të gjithëpranuara nga media dhe nga vetëdija publike e asaj epoke.

Për Hillin, sidoqoftë, lartësia e disa titanëve të industrisë dhe financave të asaj kohe arriti një lloj fuqie religjioze dhe shërbeu si frymëzim i ideve dhe veprimeve të tij. Dhe ai i detyroi të tjerët t'i shikojnë këta njerëz si burra modelë të suksesit, që e tërhiqnin suksesin dhe të mirat e përgjithshme drejt vetes falë aftësive të tyre personale.

Për Napoleon Hillin depresioni i madh ishte një dështim moral. Çfarë do të thoshte ai tani për krizën aktuale në tregun financiar, kolapsin e sistemit bankar të vitin 2008 dhe recesionet e shumta pasuese që kanë prekur jetët e gjithsecilit prej nesh? Kush do ta pranojë këtë libër në vitin 2011 e më

tej?

Panteoni i studimeve të tij përfshinte Karnexhin, Edisonin, Fordin dhe Rokfelerët. Secili nga këto maja është analizuar dhe rianalizuar më pas nga historianët, ekonomistët dhe biografët, dhe janë shqyrtuar nga afër edhe nga publiku i përgjithshëm. Për Hillin ato nuk ishin figura historike, por liderë bashkëkohës në skenën botërore, siç ishte Adolf Hitleri, Benito Musolini, Franklin Ruzvelti, Uinston Çërçilli etj. Hilli nuk e kritikoi konkurrencën e ashpër të Rokfelerëve, por ai, me siguri, nuk ishte i vetëdijshëm për antisemitizmin e Fordit.

Për Hillin, shoqëria amerikane dhe sistemi i lirë tregtar ishte shpresa më e madhe për botën. Lëkundjet ekonomiko-financiare dhe provat që u bënë në vendin e tij ai i pa si dredhi të djallit, dhe nuk kishte asgjë tokësore që do të mund të krahasohej me këtë.

Për individët që bënë një zgjidhje personale për të pasur sukses në jetë, të cilët i rezistuan joshjes dhe dobësive të laikëve, patën ndihmën e Zotit (i quajtur me terma të ndryshëm në libër). Kufijtë ishin të vetëimponuara ose të vëna nga forcat e jashtme negative të së keqes, të personifikuara nga djalli.

Pra, cili është besimi i Hillit? Sinqerisht, kjo për mua nuk ka shumë rëndësi. Unë jam ndikuar shumë nga filozofia e Napoleon Hillit dhe jam magjepsur nga jeta e tij dhe asnjëherë nuk ka pasur rëndësi për mua në cilën kishë shkonte ose nëse mori pjesë në ndonjë meshë. Për mua më e rëndësishme është pyetja: çfarë na mëson ai sot për rolin e besimit në jetën tonë.

Përgjigjen për këtë pyetje ua lëmë juve ta gjeni. Unë mendoj se kjo është çështja themelore që ju e gjeni në çdo rresht të këtij libri. Mbi të gjitha, ai zgjodhi këtë lloj zhanri klasik të

dialogut filozofik dhe pastaj vazhdoi duke na ndeshur me figurat më antireligjioze të të gjithë literaturës (nga bibla, përmes Miltonit, përmes C. S. Lewis). Ende vazhdoj të magjepssem nga kjo zgjedhje, sepse kjo e lejon Hillin të shfaqë një stil shumë interesant, që na bën të kemi një besim shumë të madh te teoritë e sjelljeve njerëzore. Ai na jep leksione të shquara për të gjithë ne.

Përderisa ti jeton dhe has pengesa të shumta përgjatë rrugës që ndjek, ky libër mund të të shërbejë që të rishikosh shtatë parimet e Hillit për mposhtjen e djallit në jetën tënde.

1. *Qëllimi i përcaktuar: zotërimi i vetvetes*
2. *Të mësosh nga fatkeqësitë*
3. *Të kontrollosh ndikimin e mjedisit (shoqërimin)*
4. *Faktori "kohë" (t'i japësh përbershmëri pozitive) në vend të shprehisë së mendimit negativ*
5. *Të zhvillosh urtinë*
6. *Të zotërosh harmoninë (të veprosh me një synim të përcaktuar dhe të ndikosh në mjedisin tënd mendor, shpirtëror dhe fizik)*
7. *Të tregosh kujdes (të mendosh përmes planit tënd para se të veprosh)*

Në rishikimin e këtyre shtatë parimeve, ju mund të identifikoni dhe të zbuloni se çfarë ju ndalon të arrini kulmin e suksesit tuaj personal.

Ishte një bekim i jashtëzakonshëm për mua, që fondacioni i Napoleon Hillit ma besoi këtë dorëshkrim, i cili qëndronte i fshehur për pothuajse 70 vjet (ose nga gruaja e tij, ose nga vetë djalli, vendoseni vetë këtë gjë). Motoja e tyre është: mësuesi paraqitet kur studenti është gati. A ju duket juve se "*Mendo dhe*

*pasurohu*" ishte mesazhi i duhur gjatë depresionit të madh dhe se "Mposhtja e djallit" është mesazhi i duhur për kohërat e sotme?

Unë besoj se në punën tonë do të shikojmë dorën e Zotit dhe jo të djallit. Gjithashtu besoj se "Mposhtja e djallit" nuk u publikua derisa Zoti mendoi se mesazhi i duhur duhej të vinte në kohë të duhur... tani në vitin 2011 për ne. Ky libër ndikoi jashtëzakonisht shumë në jetën time dhe unë shpresoj se edhe ju do të gjeni në të vlerat e jetës suaj!

***Fjalët e Napoleon Hillit sjellshin te ju shpresën, guximin dhe, mbi të gjitha, përcaktimin e qëllimit të jetës suaj ...***

***Qofshi të bekuar!***

**- Sharon Lechter**

## Për autorët



**Napoleon Hilli**  
1883-1970

Napoleon Hilli lindi më 1883 në malet e largëta të Virxhinias. Ai u rrit në një familje të varfër. Nëna e tij vdiq kur ishte vetëm 9 vjeç. Një vit më vonë babi i tij u martua përsëri dhe njerka e tij u bë burimi i frymëzimit për të.

Nën ndikimin e njerksës së tij, Hilli u bë një reporter i një gazete qëkur ishte adoleshent. Shkrimet e tij ndikuan te Robert I. Taylor, ish-gubernator i "Tennessee" dhe më vonë senator i SHBA-ve. Taylor ishte pronari i revistës "*Bob Taylor's*" dhe e punësoi të riun Hill që të shkruajë histori sukcesi. Në këtë kohë Hilli u regjistrua në fakultetin e drejtësisë.

Në vitin 1908, Hilli iu caktua të bënte një intervistë me Andrew Carnegie dhe kjo intervistë prej tri orësh u shndërrua në një intervistë që zgjati tri ditë. Ndërsa Hilli po e intervistonte, Carnegie i dha atij një ide për organizimin e filozofisë së parë botërore për arritje personale, bazuar në parimet e suksesit.

Carnegie i hapi rrugët Hillit për të intervistuar gjigantët e kohës së tij, si Henry Ford, Thomas A. Edison dhe John D. Rockefeller. Hilli kaloi njëzet vite të jetës së tij duke bërë intervista të ndryshme, duke studiuar dhe shkruar për individët e suksesshëm.

Pas njëzet vitesh që Hilli intervistoi Andrew Carnegie, më 1928 shkroi "*Ligjin e suksesit*", me 8 volume. Ai shkroi shumë bestsellera gjatë jetës së tij. Në vitin 1937, Hilli shkroi "*Mendo dhe pasurohu*", që u bë dhe libri më i shitur i të gjitha kohërave, për ndihmesën që iu dha njerëzve. Ai u shit me miliona kopje kudo rreth e qark botës. Kështu Hilli shpesh prezantohej nga të tjerët si njeriu i mrekullive dhe krijuesi i milionerëve.



## Për autorët



Sharon Lechter

Përveçse një përkrahëse e edukimit për një jetë më të gjatë, Sharon Lechter është themeluese e *Pay your family first*, një organizatë edukativo-financiare. Sharon punon si prezantuese te *National CPA Financial Literacy Commission*. Në vitin 2008, Sharon u takua me këshilltarin për marrëdhëniet financiare të presidentit, që shërbeu për të dy presidentët, Bush dhe Obama.

Sharon është një ndërmarrëse, autore, filantropiste, edukatore, prezantuese ndërkombëtare, kontabiliste e certifikuar publike, si dhe nënë. Ajo ka qenë pioniere në zhvillimin e teknologjisë, programeve dhe produkteve, për të sjellë edukimin në jetën e fëmijëve, në mënyra të reja, sfiduese dhe argëtuese. Shkrimi i saj financiar, “Koha e adoleshencës” dhe risitë që solli në jetën me mënyrat eksperimentale dhe lojën pararealiste, kanë arritur të vlerësohen maksimalisht dhe të marrë çmimet, si: “Mamaja e artë”, çmimin e akorduar nga revista “Fëmija krijues” më 2010, “Loja e vitit” për lodrat më të mira për pushime, si dhe vlerësimin prej 5 yjesh nga “Wts toy reviews”. Sharon njihet si një eksperte në temat për edukimin financiar për fëmijët, financat personale dhe me ndërmjetësi.

Sharon është autore e bestsellerit “Tre hapa larg arit” në bashkëpunim me fondacionin e Napoleon Hillit dhe Greg Reid. Sharon, gjithashtu, është shumë e njohur rreth e qark botës si bashkautore e bestsellerit ndërkombëtar “*Nju-Jork Times*, baba i pasur - baba i varfër” dhe i katërmëdhjetë librave të tjerë të serisë “Babai i pasur”.

Si një filantropiste e zotuar, Sharon ka ndihmuar shumë njerëz nëpër botë si bamirëse vullnetare. Ajo punon në bordin kombëtar të “Women presidents’ organization” dhe “Childhelp!”, një organizatë e themeluar për të parandaluar abuzimin me fëmijët.